L I G J
Nr.9027, datë 13.3.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT USHTARAK DHE CIVIL SHQIPTAR NË QENDRËN STËRVITORE NDËRKOMBËTARE PËR OPERACIONET MBËSHTETËSE TË PAQES"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë për pjesëmarrjen e personelit ushtarak dhe civil shqiptar në qendrën stërvitore ndërkombëtare për operacionet mbështetëse të paqes".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3753, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS GREKE

"Për pjesëmarrjen e personelit ushtarak dhe/ose civil shqiptar në qendrën stërvitore ndërkombëtare për operacionet mbështetëse të paqes"

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë e njour si "Palë" dhe Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës Greke tani e në vazhdim e njohur si "Pala pritëse" dhe tani e në vazhdim të quajtura si "Palë":

duke pasur parasysh që bashkëpunimi politiko-ushtarak mbështetet në elementet bazë për të rritur aftësitë e OKB-së;

duke pasur parasysh që bashkëpunimi i dyanshëm do të kontribuojë për stabilitetin në Europë dhe do të ndihmojë në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve;

duke pasur besimin se do të ekzistojë një zhvillim i tillë në bashkëpunim dhe dialogim ndërmjet shteteve të lidhura me operacionet mbështetëse për paqen tani dhe në vazhdim të njohura si "PSOs";

duke dëshiruar të kontribuojnë për përmirësimin e stërvitjeve dhe ndërveprimeve të Forcave të Armatosura të tyre në përputhje me kërkesat e reja operacionale të "PSOs";

duke respektuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja NATO-SOFA-PfP dhe protokolleve plotësuese, e cila u nënshkrua në Bruksel, më 19 janar 1995,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që të krijojë një strukturë ligjore, e cila është e nevojshme për pjesëmarrjen e personelit ushtarak dhe civil shqiptar në qendrën stërvitore ndërkombëtare për operacionet mbështetëse të paqes (MPSOTC) tani dhe në vazhdim e njohur si "Qendra".

Neni 2
Parimet kryesore

1. "Pala pritëse" merr përsipër që të sigurojë instalimet/lehtësitë e kërkuara, infrastrukturën e duhur për sistemet mbështetëse të komunikacionit dhe informacionit, ashtu si dhe logjistikat e nevojshme për të bërë të mundur funksionimin e Qendrës dhe përmbushjen e misionit të saj.

2. Palët sigurojnë që aktivitetet e Qendrës të jenë në përputhje me qëllimet dhe parimet kryesore të OKB-së.

3. Pjesëmarrja në aktivitetet e Qendrës nuk është e drejtuar kundër ndonjë shteti tjetër dhe gjithashtu nuk ka si qëllim që të stërvisë personelin ose forcat ushtarake kundër çdo shteti tjetër ose grup shtetesh.

4. Stërvitja e ofruar në Qendër do të jetë transparente, kalendari akademik do të jetë i siguruar në kohë nga Pala pritëse në përputhje me kërkesat e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Aktivitetet e Qendrës janë në përputhje me parimet bazë të OSBE-së, të cilat janë të përfshira gjithashtu në Marrëveshjen e PfP-së. Këto aktivitete do të ndihmojnë në stërvitjen e individëve dhe grupeve të Palës në kompletimin e operacionet e mbështetjes së paqes të propozuara për ta, nga organizatat ndërkombëtare.

6. Kjo Marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga traktatet ose Marrëveshjet që ata kanë nënshkruar më parë.

Pala pritëse mban të drejtën e plotë të fillojë diskutimet për të nënshkruar dhe marrëveshje të tjera bilaterale, me natyrë të njëjtë, me shtete të tjera ose organizata ndërkombëtare. Pala do të informohet rreth nënshkrimit të disa marrëveshjeve të tilla.

8. Gjuha e punës në Qendër do të jetë gjuha angleze.

Neni 3
Misioni i Qendrës

1. Misioni i Qendrës është të sigurojë nivel të lartë edukimi teorik, praktik, si dhe trajnime të skuadrave dhe të trupave ndërkombëtare, për operacionet e mbështetjes së paqes në përputhje me standardet e organizatave përkatëse ndërkombëtare të tilla si OKB, OSBE, NATO, BE.

2. Qendra, në bazë të një plani të përcaktuar të misionit, merr përsipër të sigurojë stërvitjet e orientuara, në të gjitha aspektet e operacionet e mbështetjes së paqes, të oficerëve të stafit vëzhgues ushtarak dhe kontingjenteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të sigurojë vendqëndrimet e tyre, para se të bëhet planizimi për një mision specifik.

Neni 4
Organizimi

1. Qendra është një strukturë e pajisur me personel në tri degë të FA-së greke, e cila është nën kontrollin e Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare të Palës pritëse.

2. Tabela e organizimit të Qendrës është në aneksin A, e cila është modifikuar nga Pala pritëse në përputhje me kërkesat e funksionimit të Qendrës.

3. Personeli i përhershëm (mësimor dhe administrativ i Qendrës) do të përbëhet nga personel ushtarak nga forcat tokësore, ajrore dhe detare ashtu si dhe personel civil.

4. Pala pritëse do të sigurojë të gjithë personelin e nevojshëm ushtarak dhe civil, përveç pozicioneve të mëposhtme të cilat duhet të plotësohen me personel ndërkombëtar:

a) oficerët e stafit;

b) instruktorët.

5. Pala duhet të sigurojë instruktorë në bazë të një memorandumi mirëkuptimi.

6. Pala ka të drejtën të tërheqë nga Qendra, instruktorin e përmendur më lart, vetëm pas njoftimit zyrtar me shkrim, i cili i bëhet Palës pritëse të paktën 30 ditë para ditës së caktuar për të bërë tërheqjen.

Neni 5
Stërvitja

1. Qendra do të sigurojë kurset si më poshtë vijon:

a) Kursin ndërkombëtar të oficerëve për operacionet e mbështetjes së paqes (Kursi bazë dhe i avancuar).

1. Kohëzgjatja: dy javë.

2. Numri i kurseve për vit: 4 (katër).

3. Është përgatitur për oficerët e rinj dhe madhorë (Trajnim i trajnuesve).

4. Qëllimi i kursit është që t'i stërvisë dhe t'i përgatisë oficerët për operacionet e mbështetjes së paqes, e lidhur kjo me detyrat dhe përgatitjen si vëzhgues ushtarak, mbikëqyrësit e zgjedhur ose për misione të tjera mbështetëse të organizatave ndërkombëtare të tilla si: OKB, NATO, OSBE dhe BE.

5. Pjesëmarrja maksimale kombëtare për kursin: 5 oficerë trajnues.

b) Kursi i kompanive ndërkombëtare për operacionet e mbështetjes së paqes (Kursi bazë dhe i avancuar).

1. Kohëzgjatja 2 javë: gjatë javës së parë, stërvitja do të zhvillohet për çdo togë, ndërsa gjatë javës së dytë, për çdo kompani.

2. Numri i kurseve për vit: 2 (dy).

3.Qëllimi i kursit është të stërvisë, togat dhe kompanitë për pjesëmarrje në operacionet e mbështetjes së paqes, si dhe në formacionet kombëtare dhe në ato ndërkombëtare dhe të sigurojë detyrat e nevojshme të përshtatshme përpara zhvillimit të stërvitjes. Programi i kursit siguron mësime teorike dhe praktike të drejtimit në klasë dhe në terren.

4. Minimumi i pjesëmarrjes së një vendi: organika e një toge.

c) Kursi ndërkombëtar për operacionet e mbështetjes së paqes për logjistikën.

1. Kohëzgjatja: 1 javë.

2. Numri i kurseve për 1 vit: 1(një).

3. Qëllimi i kursit është të stërvisë dhe përgatisë oficerë nga vende të ndryshme për caktimin si oficerë shtabi logjistik të shtabit të brigadës ose në shtabet shumëkombëshe mbështetëse dhe/ose në kontingjentet kombëtare për drejtimin e operacioneve të mbështetjes së paqes.

4. Kursi do të sigurojë mësime teorike dhe praktike brenda në klasë në pikat e komandimit dhe në terren.

5. Maksimumi i pjesëmarrjes së një vendi për kurs: 5 oficerë trajnues.

d) Inspektorët e CFE/shoqërues.

1. Kohëzgjatja: 2 javë.

2. Numri i kurseve për një vit: 1(një).

3. Qëllimi i kursit është të stërvisë dhe të përgatisë oficerë dhe personelin në kryerjen e detyrave si inspektorë dhe shoqërues, siç është parashikuar në Traktatin e Forcave Konvencionale të Europës (CFE).

4. Programi i kursit sigurohet për të dy mësimet teorike dhe praktike.

5. Maksimumi i pjesëmarrjes së një vendi për kurs: 5 oficerë trajnues.

e) Kursi i vëzhguesve ushtarakë.

1. Kohëzgjatja: 1 javë.

2. Numri i kurseve për një vit: 1(një).

3. Qëllimi i kursit është të stërvisë dhe të përgatisë oficerë nga vende të ndryshme si vëzhgues ushtarakë në operacionet e mbështetjes së paqes dhe të njohë të trajnuarit me procedurat e komandim-drejtimit të strukturës së NATO-s, procedurat dhe standardet e punës dhe terminologjinë.

4. Programi i kursit sigurohet për të dy mësimet teorike dhe praktike, drejtohet në klasë dhe jashtë saj.

5. Maksimumi i pjesëmarrjes së një vendi për kurs: 5 oficerë trajnues.

f) Kontrolli i kufirit/kursi i sigurimit.

Kohëzgjatja: 1 javë.

Numri i kurseve për një vit: 1 (një).

3. Qëllimi i kursit është të stërvisë dhe të njohë oficerë dhe nënoficerë nga vende të ndryshme në të gjitha aspektet e regjimit të kontrollit të kufirit, të jenë të aftë të vendosin, organizojnë, plotësojnë me njerëz, pajisje dhe stërvisin njësitë e kontrollit të kufirit.

4. Programi i kursit sigurohet për të dy mësimet teorike dhe praktike, në klasë dhe në terren.

5. Maksimumi i pjesëmarrjes së një vendi për kurs: 5 oficerë trajnues.

2. Në diplomim të trajnuarit do të marrin certifikatën zyrtare të kursit të përgatitur nga Qendra.

3. Në muajin maj të çdo viti, Pala pritëse duhet t'i sigurojë kalendarin akademik për vitin e ardhshëm, Palës dhe organizatave përkatëse ndërkombëtare.

4. Kushtet e këtij neni, mund të ndryshohen në çdo kohë nga Pala pritëse, e cila është e detyruar të lajmërojë Palën të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara hyrjes në fuqi të kushteve të reja.

Neni 6

Procedurat

1. Të gjitha informacionet që lidhen me numrin e pjesëmarrësve dhe procedurat e transportimit, të drejtën e armatimit gjatë hyrjes dhe daljes, si dhe detaje të tjera do të sigurohen nga një trupë përgjegjëse e cila bashkë me trupën përkatëse të Palës pritëse, do të përcaktojnë dhe bëjnë të mundur planin për marrjen dhe transportimin e personelit nga pika hyrëse në Qendër.

2. Informacioni i mësipërm do të paraqitet në Shtabin e Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare Greke të paktën një muaj përpara datës së mbërritjes së personelit shqiptar dhe do të publikohet në një "Raport të përbashkët" të Palëve.

3. Pala duhet të dërgojë në Qendër, informacionet për organikën, pajisjet e plota të trupave që do të stërviten për togat ose kompanitë. Në këtë rast ajo do të konsultohet me Palën pritëse për strukturën e kontingjentit të saj, si dhe për të gjitha detajet që lidhen me mbërritjen, sistemimin dhe nisjen.

4. Qendra ka të drejtën ekzkluzive që gjatë kursit të organizojë stërvitjen, me qëllim që të

krijojë kushtet e përshtatshme për drejtimin e stërvitjes.

5. Largimet ose mungesat e paarsyeshme nuk janë të lejuara gjatë kursit. Në situata emergjente dhe pas një njoftimi me shkrim nga autoritetet përgjegjëse të Palës, Komandanti i Qendrës mund të lejojë lëvizje të shkurtra për secilën Palë, si për Greqinë, ashtu edhe për shtetin e origjinës.

6. Të trajnuarit gjatë kursit, do të mbajnë uniformat e shërbimit ose uniformat e stërvitjes, të cilat do të jenë të përcaktuara në planin kalendarik të kursit.

7. Të trajnuarit e huaj duhet të pajtohen me rregullat e sigurimit të Palës pritëse.

Neni 7
Juridiksioni

1. Statusi ligjor i personelit të dërguar nga Pala në territorin grek, sipas Marrëveshjes aktuale, duhet të udhëhiqet nga Marrëveshja ndërmjet Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shtetet e tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe mbështetur në statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 19 janar 1995.

2. Komandanti i Qendrës ka kompetencë të nxjerrë urdhra, në lidhje me funksionimin e Qendrës. Këto urdhra janë të vlefshëm edhe për të gjithë personelin trajnues. Personeli shqiptar duhet të zbatojë dhe t'i respektojë këto urdhra, për aq sa nuk bien në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

3. Bazat e komandimit dhe të disiplinës të çdo kontingjenti kombëtar të Palës, janë në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar.

4. Korrespondenca zyrtare e Qendrës me Palën do të bëhet nëpërmjet drejtorisë përkatëse.

Neni 8
Mbështetja e shtetit pritës

1. Pala pritëse është përgjegjëse për të siguruar mbështetje logjistike dhe administrative për një funksionim sa më të mirë të Qendrës.

2. Detajet e nevojshme që kanë të bëjnë me "Mbështetjen kombëtare pritëse" do të jenë përcaktuar në një memorandum mirëkuptimi të nënshkruar nga të dy Palët.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet e lindura nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje duhet të zgjidhen me konsultime direkte ndërmjet Palëve, pa iu drejtuar një pale të tretë.

Neni 10
Ndryshime

1. Palët kanë të drejtë të propozojnë me shkrim, ndryshime për ndonjë nga nenet e kësaj Marrëveshjeje.

2. Në qoftë se bien dakord të dy Palët, këto ndryshime do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e përshkruara në nenin 11 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Propozimet në bazë të pikave 1 dhe 2 të këtij neni nuk bien në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 2 dhe nenin 5, paragrafi 4 të Marrëveshjes.

Ndryshimet e propozuara në pikën 3 të këtij neni, nuk do të mund të kenë efekte të njëanshme për Palën pritëse.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Marrëveshja, si dhe aneksi "A" pjesë e pandarë e saj, hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit, me të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën, në formë të shkruar, se kanë mbaruar procedurat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12
Kohëzgjatja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore të pakufizuar, në qoftë se asnjëra nga palët nuk e ka denoncuar me anë të njoftimit përmes kanaleve diplomatike të paktën 6 muaj para datës së dëshiruar për përfundimin e Marrëveshjes.

2. Në rastin kur të drejtat dhe detyrimet financiare mbeten të pazgjidhura në momentin e përfundimit, kushtet e Marrëveshjes që kanë të bëjnë me to do të mbeten në fuqi, derisa detyrimet financiare të jenë përmbushur përfundimisht nga Palët.

Kjo Marrëveshje (së bashku me aneksin "A") hartohet në tri kopje origjinale, përkatësisht në gjuhën shqipe, greke dhe angleze duke qenë të gjitha tekstet autentike. Në rast se konstatohen ndryshime në këto gjuhë, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua në Athinë, më 25 nëntor 2002.

Për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë	Për Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Greqisë
Gjeneral Brigade Luan Hoxha Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit	K/admiral Konstantinos Pahqis Drejtor i Përgatitjes në Shtabin e Përgjithshëm të Mbrojtjes Kombëtare